



**Office of The Auditor General  
Zyra e Revizionit Gjeneral  
Kancelarija Generalnog Revizora**



**Nr. i Dok.: 20.2.1-2006-08**

**RAPORTI I ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM MBI  
PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS SË PRESIDENTIT TË  
KOSOVËS PËR VITIN 2006**

**Prishtinë, MAJ 2007**

## PËRMBAJTJA

		<b>Faqe</b>
<b>0.</b>	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>	<b>3</b>
<b>1.</b>	<b>Hyrje</b>	<b>4</b>
1.1	Korniza e Auditimit	4
1.2	Fushëveprimi i Auditimit në ZPK për vitin 2006	4
1.3	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)	4
1.4	Struktura e raportit	5
1.5	Kufizimet	5
<b>2.</b>	<b>Menaxhimi Financiar</b>	<b>6</b>
2.1	Raportimi i informatave financiare	6
2.2	Kontrolli i brendshëm	6
<b>3.</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>7</b>
3.1	Hyrje	7
3.2	Pagat dhe mëditjet	7
3.3	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalit	8
3.3.1	Hyrje	8
3.3.2	Të gjeturat nga testet	9
<b>4.</b>	<b>Menaxhimi i pasurisë</b>	<b>10</b>
<b>5.</b>	<b>Rekomandimet vijuese nga viti 2005</b>	<b>11</b>
<b>6.</b>	<b>Opinionin e Auditimit</b>	<b>12</b>
6.1	Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit	12
6.2	Opinionin e auditimit	12
<b>7.</b>	<b>Rekomandimet</b>	<b>113</b>
Aneksi 1	Te gjeturat e detalizuara te prokurimit	14
Aneksi 2	Komentet e Zyrës së Presidentit	17

## 0. Përmbledhje ekzekutive

Zyra e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare 2006 të Zyrës së Presidentit të Kosovës (ZPK). ZPK përfaqëson unitetin e popullit dhe garanton funksionimin demokratik të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse.

ZAGJ ishte e kënaqshme të vërej përmirësimet tek zhvillimi i kontrollës së brendshme në ZPK. Gjatë vitit 2006 ZPK ka themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm. Sidoqoftë, kontrolla e brendshme tek ZPK ende përmban disa dobësi të dukshme.

Çështjet kyçe që ndikojnë tek opinioni i ZAGJ në Pasqyrat Financiare të entiteteve janë regjistruar si më poshtë.

Së pari, sa i përket menaxhimit financiar të ZPK, të gjeturat kyçe janë :

- Pasqyrat Financiare janë përgatitur në bazë të regjistrave të SIMFK - Free Balancit të Thesarit jo në bazë të regjistrave të veta të ZPK;
- Nuk mbahen shënime të vazhdueshme mbi shpenzimet e ZPK;
- Regjistrat e pasurisë nuk janë complete;

Se dyti, sa i përket prokurimit tek mallrat, shërbimet dhe shpenzimet kapitale. ZAGJ vëren që:

- Mos pajtueshmëria me procedurat e prokurimit është mjaft e përhapur;
- Kushtet e kontratës nuk janë respektuar mbasi që kontrata është nënshkruar.

Në bazë të rëndesës të çështjeve të përmendura më lartë, ZAGJ nxjerr një opinion të kundërt në lidhje me paraqitjen e drejt dhe të vërtet të Pasqyrave Financiare 2006 të ZPK.

## 1. Hyrje

### 1.1 Korniza e auditimit

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë kreun 8.1(e) dhe (x) kreun 11.1 (c) si dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/18 për Themelimin e Zyrës së Revizorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Revizionit të Kosovës krijojnë bazën e ligjore të funksionimit të ZRGJ-se. Sipas nenit 3.2 të kësaj rregulloreje, nga Auditori Gjeneral (AGJ) kërkohet të kryej auditimin e rregullt vjetor të të gjitha institucioneve të Kosovës, duke përfshirë:

- nëse pasqyrat financiare japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë;
- nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- përkatësinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative të zbatuara në kuadër të institucionit ose të entitetit që iu është nënshtruar auditimit; si dhe
- të gjitha çështjet të cilat dalin ose kanë të bëjnë me auditimin;

Në muajin mars të vitit 2003, Kuvendi i Kosovës e ka nxjerr Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 2003/2 (LMFPP), i cili ligj edhe formalisht është shpallur nga PSSP- me Rregulloren nr 2003/17 të datës 12 maj 2003.

### 1.2 Fushëveprimi i auditimit të ZPK për vitin 2006

Objektiva primare e këtij auditimi është që t'i mundësohet ZAGJ-së që të japë opinionin nëse pasqyrat financiare të ZPK japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë për shpenzimet e kryera gjatë vitit i cili ka përfunduar më 31 dhjetor 2006, si dhe nëse janë përgatitur në pajtim me Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik (SNKSP) lidhur me "raportimin financiar sipas kontabilitetit të parasë së gatshme". SNKSP-të janë nxjerr nga Bordi i standardeve ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik (BSNASP) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

### 1.3 Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNK)

Pasqyrat financiare të ZPK për vitin 2006 kanë qenë subjekt i auditimit të pavarur i cili është realizuar në pajtim me SNK-të e Bordit të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit, i cili funksion si organ i veçantë në kuadër të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) të standardeve ndërkombëtare të zbatueshme për sektorin publik. Këto standarde e përcaktojnë kornizën ndërkombëtare sipas së cilës Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i kryejë detyrat dhe t'i përfshijë çështjet siç janë, parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rrezikut dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmitë e auditimit, mbështetja në punë e të tjerëve dhe konkluzionet si dhe raportimi i auditimit.

Standardi i caktuar Ndërkombëtar i Auditimit që përcakton konkluzionet e auditimit dhe të raportimit, siguron formën dhe të shprehurit standard i cili duhet të adoptohet kur një auditor jep një opinion të qartë ose të pandryshuar të auditimit, si dhe udhëzojnë se kur një auditor duhet të japë një opinion të kualifikuar ose të modifikuar të auditimit.

Një opinion i modifikuar i auditimit duhet të jepet për këto situata vijuese:

- kur auditori vjen në përfundim që sipas të dhënave të marra të auditimit, pasqyrat financiare nuk janë pa gabime materiale për shkak të mospajtit me menaxhmentin lidhur me (i) pranueshmërinë e politikave të zgjedhura të kontabilitetit, (ii) zbatimin e politikave

të zgjedhura të kontabilitetit ose (iii) përshtatshmërinë e shpalosjes në pasqyrat financiare. Prandaj, auditori vjen në përfundim që pasqyrat financiare nuk janë përgatitur nga të gjitha aspektet në pajtim me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar; apo

- kur auditori nuk mund të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për të arritur në përfundim që pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Pas kësaj, auditori e jep gjykimin profesional lidhur me materialitetin dhe shtrirjen e ndikimit të çështjes duke i dhënë rëndësi ndryshimit për marrjen e vendimit lidhur me llojin e opinionit i cili duhet të lëshohet, si në tabelën më poshtë:

**Tabela 1 Radha e opinionëve të mundshme të auditimit**

Natyra e çështjes e cila i jep rëndësi ndryshimit	Ndikimet ose ndikimet e mundshme të pasqyrave financiare	
	Materiale	Materiale dhe të Depërtueshme
Mospajtimi me udhëheqësin	Opinion i kualifikuar	Opinion i kundërt
Pamundësia për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse	Opinion i kualifikuar	Refuzim i opinionit

Nga kjo rrjedh që refuzimi i opinionit lëshohet atëherë kur auditorët nuk mund të përcaktojnë nëse zërat e renditur në pasqyrat financiare janë apo mund të jetë të ndikuara nga pamundësia e tyre për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse dhe për shkak që është vështirë ose e pamundur për ata që t'i përshkruajnë qartë ndikimet lidhur me pasqyrat financiare në raportet e tyre të auditimit. Kështu, për pasqyrat financiare nuk është dhënë asnjë opinion.

#### 1.4 Struktura e raportit

Hyrja në kaptinën 1 shoqërohet me kaptinat vijuese të cilët shtjellojnë këto pika:

- Kaptina 2 Menagjimi Financiar
- Kaptina 3 Shpenzimet
- Kaptina 4 Menaxhimi i Pasurisë
- Kaptina 5 Rekomandimet vijuese nga 2005
- Kaptina 6 Opinioni i Auditimit
- Kaptina 7 Rekomandimet
- 

#### 1.5 Kufizimet

Të gjeturat tona të auditimit, mbështeten në dokumentacionin dhe në informatat apo shpjegimet e tjera të cilat na janë ofruar gjatë procesit të auditimit. Është e mundur që të ketë edhe të dhëna të tjera shtesë e të cilat nuk na janë dhënë, gjë që kanë mundur të ndikojnë në ndryshimin e të gjeturave me të cilat kemi disponuar.

**Ne takimin ton përmbyllës të datës 10.05.2005, ZPK nuk ka pranuar të nënshkruaj Letrën e Përfaqësimit, për këtë arsye dyshohet se ZPK nuk na i ka ofruar të gjithë dokumentacionin relevant gjatë auditimit, dhe kjo ka ndikuar që disa nga të gjeturat tona të ndryshojnë në raport.**

Të gjeturat e hollësishme të auditimit të përfshira në raport janë ilustrime të çështjeve kyçe që janë gjetur gjatë auditimit të pasqyrave financiare të ZPK, por që nuk duhet të merren se mund t'i shpalosin të gjitha çështjet e gjetura gjatë procesit të auditimit.

## **2. Menaxhimi Financiar**

### **2.1 Raportimi i të Dhënave Financiare**

Departamenti i Thesarit në MEF e ka nxjerr Udhëzimin Administrativ nr. 2006/14 Raportimi vjetor i organizatave buxhetore, për entitetet të cilat financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, me të cilin obligohen që ta paraqesin raportin financiar për parën e gatshme sipas Standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik. Afati i fundit për raportim ka qenë 31 janar 2007.

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrave financiare të ZPK për vitin 2006 nëse janë në pajtim me Udhëzimin Administrative 2006/14.

Nga ky Auditim ne kemi vërejtur se Pasqyra Financiare nuk është bazuar në regjistrin e ZPK. Në vend të kësaj është bazuar në regjistrin SIMF - Free Balancit nga Thesari. Së pari duket se ZPK nuk regjistron shpenzimet për paga dhe mëditje. Se dyti, ne kemi gjetur një dallim negativ përparësisht një-mije Euro ndërmjet regjistrit të ZPK dhe të Thesarit sa i përket shpenzimeve tek mallrat dhe shërbimet.

ZAGJ konsideron se kjo punë nuk është në pajtim me Udhëzimin Administrativ të përmendur i cili jep përshtetimin se Pasqyrat Financiare duhet të bazohen në llogaritjet e veta të Organizatës Buxhetore.

### **2.2 Kontrolla e brendshme**

Në kuadër të ZPK është themeluar Njësia e Auditimit të brendshëm që nga Dhjetori 2006.

ZAGJ ka vërejtur se Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur një plan punues për vitin 2007. Raporti i Auditimit të parë që është përqendruar në logjistik/transport është kompletuar në Shkurt 2007. Ky raport identifikon një numër të parregullsive dhe jep rekomandime. Ne rekomandojmë menaxhmentin e ZPK-së të diskutojnë për të gjeturat e tyre dhe të implementojnë rekomandimet.

Ndarja e përgjegjëse është një mekanizëm i rëndësishëm i kontrollit të brendshëm. Ne kemi vërejtur raste të ndryshme se kjo nuk është organizuar në mënyrën e duhur. Ne nxisim menaxhmentin e ZPK-së të përmirësoj strukturat organizative që të arrijë një ndarje të duhur të përgjegjëseve.

### 3. Shpenzimet

#### 3.1 Hyrje

Tabela 2 paraqet një hyrje të shpenzimeve sipas Pasqyrave Financiare

**Tabela 2 Hyrje e shpenzimeve te ZPK sipas PF 2006**

<b>Përshkrimi i shpenzimeve</b>	<b>Shuma</b>
Pagat dhe mëditjet	185,999
Mallrat dhe shërbimet	1,171,287
Komunalit	22,940
Shpenzimet kapitale	23,275
<b>Totali</b>	<b>1,403,501</b>

Tabela tregon se “ pagat dhe mëditjet”dhe “mallrat dhe shërbimet “ përbëjnë pjesën me te madhe te shpenzimeve në ZPK. Prandaj, këto kategori kanë qenë përqendrim i auditimit të ZAGJ.

#### 3.2 Pagat dhe mëditjet

##### 3.2.1 Hyrje

Shpenzimet tek pagat dhe mëditjet janë proceduar nga Ministria e Shërbimeve Publike (MSHP). Tabela 3 jep një hyrje të shpenzimeve tek pagat dhe mëditjet në vitin 2005 dhe 2006

**Tabela 3 Krahasimi i pagave dhe mëditjeve ne 2006 dhe 2005 (burimi nga: Libri Kryesor )**

<b>Përshkrimi</b>	<b>2006</b>	<b>2005</b>
Pagesat neto	154,905.05	146,600.71
Tatimet e te ardhurave personale	11,174.89	8,693.90
Kontributet e punëtorëve për pension	8,857.08	8,173.39
Kontributet e punëdhënësit për pension	8,857.08	8,173.39
Pagat e kontraktuara	2,204.98	
<b>Totali i Pagave dhe Mëditjeve</b>	<b>185,999.08</b>	<b>171,641.39</b>

Totali i të punësuarve në vitin 2006 ka qenë 44. Ngritja e shpenzimeve tek pagat dhe mëditjet është shkaktuar nga implementimi i Udhëzimit Administrativ nr. 08/2006 Masat për shtimin e efikasitetit ne Administratën publike te nxjerre nga Qeveria e Kosovës që lejon Unifikimin e kompensimit jashtë orarit te punës.

##### 3.2.2 Te gjeturat nga testet

Ne kemi audituar 20 dosje te stafit që të testojmë nëse pagesat e pagave ishin në pajtim me kontratën e punëtorit. Tabela 4 jep llogaritjen e shkallës së gabimeve në mostër .

**Tabela 4 Llogaritja e shkalles se gabimeve tek pagat dhe mëditjet**

Nr. i personave	Paga ne Peyroll	Paga ne Kontratë	Diferenca	Nr. i muajve	Gabimi
A	B	C	B-C	D	A*D*(B – C)
1	260	248	12	12	144
1	293	260	33	11	363
2	260	217	43	3	258
<b>Gabimet monetare absolute tek mostra ne euro</b>					<b>765</b>
<b>Totali i pagave dhe mëditjeve tek mostra ne euro</b>					<b>90,636</b>
<b>Totali i shkalles se gabimeve ne mostër</b>					<b>0,85 %</b>

Nga tabela vërejmë se pagat për katër punëtor tejkalojnë vlerën e kontratës për 765€. Gabimi është llogaritur duke u bazuar në periudhën e kontratave të nëpunësve për vitin 2006.

Bazuar në totalin e pagave dhe mëditjeve në mostër, ZAGJ përcakton se shkalla e gabimeve është 0,85 %. Përgjithësimi i tërë shpenzimeve tek pagat dhe mëditjet (185,999 Euro) rezulton në totalin e vlerësimit monetarë të keq deklarimit për 1,581 Euro.

### 3.3 Mallra, shërbime dhe komunalit

#### 3.3.1 Hyrje

Tabela 5 jep një hyrje të shpenzimeve të ZPK në kategorinë “mallra dhe shërbime” dhe “komunalit” bazuar në Librin Kryesor.

**Tabela 5 Hyrje tek shpenzimet per mallra, shërbime dhe komunalit (Libri Kryesor )**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti i përfunduar me 31/12/06</b>
Shpenzimet e udhëtimit	91,960.44
Shpenzimet e komunalive	22,940.44
Shërbimet e telekomunikimit	84,882.43
Shërbimet kontraktuese	374,824.62
Blerja e mobileve dhe pajisjeve me pake se 1000 euro	3,535.90
Blerja e mobileve dhe pajisjeve ndërmjet 1000 dhe 5000 €	34,515.21
Blerje tjera	348,376.16
Derivate dhe lende djegëse	79,920.18
Llogarite e avansit	3,192.00
Shërbimet Financiare	28,170.21
Mirëmbajtja	56,506.69
Qiraja	1,290.00
Shpenzimet e marketingut	11,898.70
Shpenzimet e përfaqësimit	52,214.30
<b>Totali PF</b>	<b>1,194,227.28</b>



### 3.3.2 Te gjeturat nga testet

Auditimi i shpenzimeve tek “mallrat dhe shërbimet” dhe “komunalit” është përqendruar në vet pajtim me rregullat e prokurimit. Ligjet vijuese zbatojnë:

- Ligji nr. 2003 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë e shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/17.
- Ligji nr. 2003/17 Për Prokurimin Publik ne Kosove i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/3.

Mostra përmbante 21 lëndë te prokurimit. 5 artikujt e parë janë zgjedhur me atë kriter që kanë tejkaluar shumën prej 25.000 Euro. Artikujt e tjerë janë zgjedhur rastësisht. Ky selektim rezulton në mostrën vijuese :

- Shpenzimet e udhëtimit : 3 lëndë
- Shërbimet e kontraktuara : 5 lëndë
- Blerja e pajisjeve: 2 lëndë
- Blerje tjera: 4 lëndë
- Derivate: 5 lëndë
- Mirëmbajtje: 2 lëndë

Totali i shumës monetare të mostrës është **538,787 €**. Procedura e përzgjedhjes lejon rezultatet e mostrës të përgjithësohen me tërë popullacionin prej **1,194,227 €**.

Tabela 6 tregon artikujt në të cilët procedurat e prokurimit janë shkelur. Në 7 raste janë identifikuar parregullsitë. Të gjeturat e detajizuara janë regjistruar ne aneks 1. Për më tepër, tabela jep për secilën parregullsi vlerën e vet monetare.

**Tabela 6 Parregullsitë ne mostrën “mallra dhe shërbime” dhe “komunalit”**

Artikulli	Nr i Prokurimeve	Vlera monetare	
		Paqartësitë	Gabimi
	<b>Shërbimet e kontraktuara</b>		
1	CPO nr. 06215		175,000
2	CPO nr. 030143	1,734.54	
	<b>Blerja e pajisjeve</b>		
3	CPO nr. 1020101		1,060.93
	<b>Shpenzimet për derivateve</b>		
4	CPO nr 1020163	568.29	
5	CPO nr 1020163	134.35	
	<b>Shpenzimet për mirëmbajtje</b>		
6	CPO nr. 1020129		7,505
7	CPO nr. 00707		1,724.80
<b>Totali</b>		<b>2,437</b>	<b>185,291</b>

Nga tabela mund të shihet se totali i shumës monetare i paqartësive është 187,728 € nga të cilat 185,291 € është paraqitur si gabim. Kjo është një shkallë e gabimit prej 35%. Nëse përmbledhet i tërë popullacioni për artikujt e prokurimit në kategorinë mallra dhe shërbime, totali i vlerësimeve për shumën monetare të keq deklarimeve është 417,979 € nga të cilat 412,553 € është paraqitur si gabim.

#### **4. Menaxhimi i pasurisë**

Bazuar në Udhëzimin Administrativ 2005/11 Menaxhimi dhe regjistrimi i Pasurisë Qeveritare, ZPK është e obliguar të bëj inventarizimin e të gjitha pasurive në fund të vitit fiskal.

ZAGJ ka audituar një listë të pasurive siç ishin përgatitur nga ZPK. Ne kemi vërejtur mangësitë vijuese:

- Nuk është bërë regjistrimi i pasurive në Free Balance;
- Regjistrimi për periudhën kohore 2005-2006 nuk është përgatitur në mënyrën elektronike por vetëm në të shkruar;
- Komisioni për regjistrimin e pasurive është mbështetur vetëm në faturat e furnizuesve: por ata nuk kanë tregu një konfirmim fizik të prezencës së këtyre pasurive;
- Në rastet kur pasuritë janë regjistruar në bazë të faturës që kanë përmbajtur më shumë se një artikull, atëherë artikujt janë regjistruar si grup jo në mënyrë të veçantë;
- Regjistri i pasurisë nuk është kompletuar, ne kemi vërejtur se në listë mungojnë 6 Llaptop, 1 projektor dhe veturat;
- Dy Llaptop dhe një projektor ishin në posedim të ish-personelit të ZPK dhe ende nuk janë kthyer;
- Për mostrën e 7 Llaptop të përzgjedhur ne kemi bërë ekzaminimin fizik të tyre. Ne kemi konfirmuar se 6 Llaptop ishin lokalizuar në pajtim me regjistrimin. Një punëtor nuk mundi ta tregojë llaptopin që është supozuar të ketë qenë poseduar nga ai /ajo;
- Në rastin e katër llaptopave, hollësitë teknike nuk janë përputhur me të dhënat e faturës furnizuese;
- Llaptopin me të cilin është furnizuar ZPK në 21 Nëntor 2006 me një vlerë prej 2,142€ nuk ishte regjistruar dhe nuk mund të konfirmohet fizikisht.

ZAGJ gjithashtu ka audituar edhe shfrytëzimin e veturave. Ne kemi vërejtur se:

- Regjistrimi i veturave zyrtare të ndryshme mungonte apo nuk ishte kompletuar ;
- Format që janë përdorur për shfrytëzimin e veturave nuk janë të mjaftueshme sepse nuk kanë vend të shkruhen km e përfundimit të udhëtimit zyrtar.

Bazuar në të gjeturat e lartpërmendura, ZAGJ konkludon se ZPK duhet të regjistroj pasuritë në pajtim me Udhëzimin Administrativ 2005/11. Për më tepër, ZPK duhet të sigurojë një mënyrë të drejtë të regjistrimit të kilometrave të shfrytëzimit të veturave duke përmirësuar kontrollin e brendshme sa i përket regjistrimit të kilometrave.

## 5. Përcjellja e rekomandimeve të vitit 2005

ZAGJ ka publikuar në Maj 2006 një raport të auditimit të procedurave të prokurimit dhe të menaxhimit të pasurisë për Zyrën e Presidentit të Kosovës për periudhën kohore Janar – Shtator 2005. Raporti përmbante rekomandimet vijuese :

- Të formoj një njësi kontrolluese ose të kryej një Auditim të brendshëm sa më shpejte që është e mundur me një objektiv që të caktoj një sistem për kontroll të brendshme;
- Të përgatit një plan vjetor të prokurimit për mallra, shërbime dhe punë në pajtim me rregulloret;
- Të krijojë një sistem të kontrollit të brendshëm i cili do të sigurojë që procedurat e prokurimit do të jenë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik;
- Të siguroj dokumentacion të duhur të dosjeve të prokurimit;
- Të krijoj një regjistër për gjithë pasuritë në pajtim me Udhëzimin Administrativ 11/2005 Menaxhimi dhe regjistrimi i Pasurisë Qeveritare;
- Të zhvilloj dhe të implementon një direktivë për përdorimin e pasurive.

ZAGJ ka hetuar se ZPK ka bërë një përparim në implementimin e këtyre rekomandimeve. Është krijuar njësi e auditimit të brendshëm, ka përgatitur një plan vjetor të prokurimit dhe ka bërë përparim në regjistrimin e pasurisë.

Sidoqoftë, ZAGJ gjithashtu ka vërejtur nga Auditimi i vitit 2006 se përparimi në pajtueshmëri me ligjin e prokurimit është kufizuar dhe në regjistrimin pasurive ende përmban një numër të mangësive. Prandaj, disa nga rekomandimet do të përsëriten në kaptinën 7 të këtij raporti auditues.

## 6. Opinioni i auditimit

### 6.1 Çështjet që reflektojnë opinionin e auditimit

ZAGJ, ishte e kënaqshme të vërej përmirësimet në zhvillimin e kontrolles së brendshme në ZPK. Për shembull, gjatë vitit 2006 ZPK ka krijuar një departament të auditimit të brendshëm. Sidoqoftë, kontrollat e brendshme në ZPK ende përmban disa dobësi të dukshme.

Më poshtë, çështjet kyçe të cilat ndikojnë tek opinioni i ZAGJ në Pasqyrat Financiare të ZPK janë regjistruar.

Së pari, lidhur me administrimin financiar tek ZPK, çështjet kyçe janë:

- Pasqyrat Financiare nuk janë bazuar në regjistrat e ZPK, por janë përgatitur në bazë të regjistrave të SIMFK- Free Balancit të Thesarit;
- Nuk mbahen shënime të vazhdueshme mbi shpenzimet e ZPK;
- Regjistrat e pasurisë nuk janë complete.

Se dyti, lidhur me prokurimin e mallrave dhe shërbimeve dhe shpenzimeve kapitale. ZAGJ shënon se:

- Mos pajtueshmëria me procedurat e prokurimit është e shtrirë plotësisht;
- Kushtet e kontratës nuk janë respektuar mbasi që kontrata është nënshkruar.

Tabela 7 jep një hyrje të materialitetit të këtyre çështjeve kyçe.

**Tabela 7 Përmbledhja parregullsive për Zyren e Presidentit**

Shpenzimet	Shuma në PF	Kec deklarimet e vlerësuara të PF	
		Paqartësi	Gabimi
Pagat dhe mëditjet	185,999	1,581	1,581
Mallrat dhe shërbimet	1,171,287	417,979	412,553
Komunalit	22,940		
Shpenzimet Kapitale	23,275	Nuk është audituar	
<b>Totali</b>	<b>1,403,501</b>	<b>419,560</b>	<b>414,137</b>
Niveli i Materialitetit		<b>70,175 (5%)</b>	<b>42,105 (3%)</b>

### 6.2 Opinioni i auditimit

Tabela 7 tregon se paqartësitë dhe gabimet e vërejtura tejkalojnë nivelin e materialitetit siç është vendosur në ZAGJ. Në këto baza, ZAGJ jep një opinion të kundërt sa i përket Pasqyrave Financiare të ZPK.

## 7. Rekomandimet

Bazuar në auditimin e Pasqyrave Financiare 2006 të ZPK, ZAGJ jep rekomandimet vijuese:

Lidhur me menaxhimin financiar, ZAGJ rekomandon të:

- Krijojë regjistrimin e vet për të gjitha shpenzimet në ZPK;
- Mbyllja e avancave duhet të korrespondojnë me shpenzimet e krijuara për atë qëllim për të cilin edhe janë marre ;

Lidhur me pajtueshmërinë me procedurat e prokurimit, ZAGJ rekomandon:

- Të sigurojë pajtueshmëri me kushtet e kontratës pasi që kontrata është nënshkruar;
- Të sigurojë pajtueshmëri me procedurat e prokurimit gjithashtu edhe për shpenzimet e udhëtimeve zyrtare ;
- Tek prokurimi i mallrave dhe shërbimeve, të kenë parasysh edhe shpenzimet doganore dhe taksat tjera;
- Kujdes ndaj dëmtimi të buxhetit për mos kujdesin dhe përgjegjësin e personave që vendosin mbi lidhjen e kontratave pa plan të paraparë;
- Kontrolli i brendshëm të jetë më efikas mbi kontrollin e pagesave dhe tu ikë pagesave të pa identifikuar mbi punën e kryer sipas kontratave;

Lidhur me menaxhimin e pasurisë, ZAGJ rekomandon:

- Të bëhet regjistrimi i pasurisë në SIMFK – Free Balance;
- Të përfshihet e tërë pasuria në regjistrin e pasurisë;
- Të përmirësoj sistemin e kontrolles së brendshëm sa i përket shfrytëzimit të veturave.

## **ANEKSI 1. PER TE GJETURAT E DETALIZUARA - MALLRA DHE SHERBIME TE PROKURIMIT**

### **Shpenzimet e udhëtimit**

**CPO nr. 1020176**–Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendi–përfitues ‘‘EUROKOHA’’. Vlera e paguar prej 12,260.00€ për bileta aeroplani. Mungon kërkesa dhe aprovimi për shpenzimet e udhëtimit zyrtar, nuk ka dëshmi se kush ka lejuar apo autorizuar këto udhëtime zyrtare. Përveç kësaj raporti i pranimit teknik të këtyre shpenzimeve është i pa nënshkruar.

### **Shërbimet e kontraktuara**

Nuk janë zbatuar kodet ekonomike si duhet, nga shërbimet kontraktuese janë paguar shpenzime për bileta aeroplani.

**CPO nr. 030144** - shërbime kontraktuese të kohëpaskohshme –përfitues ‘‘EUROKOHA’’. Vlera e paguar prej **7,126.00€** për bileta aeroplani, kolona e çmimeve në faturë nuk është e qartë pasi që tre persona kanë udhëtuar me të njëjtin destinacion **por vlerat janë te ndryshme**. Mungon kërkesa e aprovuar nga personat përgjegjës për pagimin e shpenzimeve për udhëtim zyrtar. Realizimi i këtyre shpenzimeve ka ndodhur me vazhdimin e kontratës me kompaninë ‘‘EUROKOHA ‘‘ pa përfillur fare procedurat e prokurimit.

**CPO nr. 06215** – ka te bëjë me kontratën nr. PISG/01/2004/J e lidhur në shtator të vitit 2004 në mes të IPVQ/ZPK dhe kompanisë Decotec S.A., Fribourg, Switzerland, për Furnizim me pajisje të sigurisë në vlerë prej 2.74 milionë euro.

- Kodi ekonomik nuk i përgjigjet shërbimit të kryer, pagesa e fundit nga marrëveshja e arritur është kryer nga shërbimet kontraktuara;
- Procedurat e prokurimit nuk janë vijuar ose zbatuar në bisedimet dhe në vendimin për lidhjen e kontratës mbi bazat që transaksioni ka involvuar marrjen parasysh të sigurisë së mjaft të ndjeshme;
- Vlefshmëria ligjore e kontratës është kontestuar më pas nga IPVQ-të dhe kontrata është ndërprerë njëanshëm para se të fillonte zbatimi i saj;
- Kontrata është nënshkruar nga Drejtori i Administratës jo nga NJQP (Njësia Qendrore e Prokurimit), prandaj UAF Nr. 2/99 mbi prokurimin publik duke shfrytëzuar mjetet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës nuk është zbatuar;
- Në vitin 2006, me ndihmën e zyrave ndërmjetëse të UNMIK-ut është arritur marrëveshja e negociuar nga palët në shumë prej 175,000 euro. Kjo shumë është paguar dhe është pranuar e plotë si dhe me marrëveshjen përfundimtare për këtë çështje.

**CPO nr. 1020191** – *Shtesat* për nëpunësit e ZPK në muajin dhjetor në vlerë prej 33,558.50€. Gjate testimi kemi vërejtur se shtesat janë paguar nga shërbimet kontraktuese, nuk është llogaritur fare tatimi, është bërë shkelje e Rregulla Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit – 02 Shpenzimi i Parave Publike ,te nxjerre nga Departamenti i Thesarit MEF dhe Udhëzimeve Administrative të thesarit: UA nr. 2005/09 Pagesat për Punëtorët me Kontrata. dhe UA nr. 2006/07 Pagesat për Personat Individual në të cilat thuhet: Të gjitha shtesat që u paguhen

personave në marrëdhënie pune, duhet të paguhen nga kategoria ekonomike e pagave dhe mëditjeve, gjithashtu tatimi duhet të llogaritet në pajtim me UA 2005/09.

**CPO nr. 030143** – ne vlere prej 7,344,80€. Paguesa është kryer me 18.07.2006, për tre persona në bazë të kontratave mbi vepër. Kontratat mbi vepër janë lidhur për një person me 14.02.2006 kurse për dy persona me 30.06.2006 me shume mujore 748.03€. Në dosje nuk figuron ndonjë dokument me arsye të tejkalimit të kontratës. Paguesa totale mujore sipas kontratave, për dy persona arrin vlerën 1,496.06, dhe diferenca e pambuluar me dokumentacion arrin vlerën 1,734.54 €.

### **Blerja e pajisjeve**

**CPO nr. 1020082**–5,394.50€-Furnizim me LLaptopa IBMTPT43 dhe pajisje tjera

**CPO nr. 1020101** – 1,517.87€ - Shpenzimet doganore

Komisioni vlerësues gjatë përzgjedhjes nuk ka pasur parasysh se operatori ekonomik “INET” është nga Maqedonia dhe për furnizim me Llaptop duhet te importohet malli dhe të paguhen shtesë, shpenzimet doganore dhe shërbimet e shpeditimit në shumë prej 1,517.87€. Autoriteti kontraktues me përzgjedhjen e “INET” nga Shkupi si furnizues me llaptop ka paguar shumën totale 6,910.93€. Autoriteti kontraktues po të ishte përzgjedhur operatori ekonomik Poker PC nga Prishtina do të kishte paguar 5,850.00€.

Konstatojmë se buxheti i Zyrës së Presidentit të Kosovës gjatë këtij prokurimi është dëmtuar për 1,060.93€.

### **Blerje tjera**

**CPO nr. 1020145** të datës 17.10.2006 në shumë prej 2,317.68 – Petty Cash

**CPO nr. 1026788** të datës 05.12.2006 në shumë prej 2,321.15 – Petty Cash

Nga transaksionet të kontrolluara kemi konstatuar se nga parat e imta janë paguar lloje të ndryshme shpenzimesh pa kërkesë dhe justifikim të mjaftueshëm se në cilën pikë shpenzuese janë përdorur parat e tërhequra. Nuk ka dëshmi të mjaftueshme se nga kush janë pranuar parat (nënshkrimi nga pranuesi).

Po ashtu janë paguar nga paraja e imët fatura nr. 14/06 në shumë prej 98.00€ dhe fatura nr. 15/06 në shumë prej 98.00€ nga i njëjti operator ekonomik. Kjo ndarje e faturës ne dy pjesë është bërë për t'i ikur tejkalimit mbi 100€. Gjatë ekzaminimit të CPO nr. 1020132 të datës 20.09.2006 është bërë një pagës në shumë prej 111.24€. Që është në kundërshtim me Rregullën Financiare dhe Udhëzimet e Thesarit – 02 Shpenzimi i Parave Publike.

### **Shpenzimet për Derivate**

**Dosja me nr te prokurimit ZPK/P/019/2005** - ( Kuotim çmimesh ) furnizim me karburante. Kontrata është lidhur me “OTI Group” gjashtëmujore më datë 14.12.2005. Gjate kësaj periudhe ZPK është furnizuar me karburante në vlerë mbi 25,000€, kjo dëshmon se ju kanë

shmangur tenderit te hapur. Gjithashtu në kontrate është cek që kontraktori t'i përmbahet çmimeve që janë dhënë në ofertë dhe mos ti nënshtrohet ndryshimeve, Mirëpo ne:  
**CPO nr 1020163** me date pagese 02.07.2006 ne vlere 7,495.37€ kemi vërejtur një diferencë ndërmjet çmimit te ofertës dhe çmimi i faturës me i larte për 568.29€,

**Dosja me nr. prokurimi 06/025/1/2/1** - furnizim me karburante, kontratë e lidhur me "OTI Group" më datë 23.06.2006. Gjate testimi te hollësishëm kemi vërejtur se ofertuesve i kanë munguar dokumentet e nevojshme sipas procedurave të prokurimit, nuk është përfillur neni 35.8 i LPP 2003/17. Gjithashtu ne kontrate është cek që kontraktori t'i përmbahet çmimeve që janë dhënë në ofertë dhe mos ti nënshtrohet ndryshimeve. Po ashtu ne:

**CPO nr 1020163** me date pagese 07.11.2006 ne vlere 6,072.02 € kemi një diferencë ndërmjet çmimit te ofertës dhe çmimit te faturës me i larte për 134.35€, dhe lënda nuk është complete, ku i mungojnë dokumentet përcjellëse për faturën nr 724 te datës 03.11.06

### **Mirëmbajtja e Automjeteve**

Gjatë testimi të hollësishëm, tek shpenzimet e mirëmbajtjes ne kemi vërejtur parregullsi të cilat kanë të bëjnë me raste të shkeljes së dispozitave ligjore, dhe në të njëjtën kohë kemi gjetur dobësi dhe mangësi të sistemit të kontrollit të brendshëm.

**CPO nr. 1020129** – Pagesa e borxhit te vjetër kompanisë "Zijadini" për autolarje ne vlere prej 3,600€. Fatura për vlerën 3,600€ nuk paraqet detajet e specifikuara te periudhës kohore se kur është krijuar shpenzimi, është e paqarte.

Pagesa tejkalon shumën e përcaktuar në kontratë për 7,505€. Kontrata është lidhur me datën 28.10.2005 ne vlere 3,600 €. Ndërsa shuma e paguar kompanisë "Zijadini" për vitin 2006 ne emër te kësaj kontrate sipas kontabilitetit te ZPK është 11,105€.

**CPO nr. 00707** – Shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve kompanisë "Reforma" në vlerë 3,100€. Po ashtu Pagesa tejkalon shumën e përcaktuar në kontratë për 1,724.80€. Kontrata është lidhur me datën 17.03.2006 ne vlere 5,000€. Ndërsa shuma e paguar kompanisë "Reforma" për vitin 2006 ne emër te kësaj kontrate sipas kontabilitetit te ZPK është 6,724.80€.

### **Komentet e Zyrës së Presidentit**

Zyrës së Presidentit iu ka dhënë mundësia per dhënien e komenteve ne draft raportin e auditimit në mënyrë që të eliminohet rreziku i keqinterpretimit dhe keqkuptimit në mes te auditorëve dhe entitetit të audituar .

Zyra e Presidentit ka bërë komentet e saja dhe ato janë përfshirë në këtë raport .



	<b>Aneksi 2</b>	
<b>Nr.</b>	<b>Komentet e Zyrës së Presidentit të Kosovës</b>	<b>Komentet e auditorëve</b>
<b>1.</b>	<b>4. Menaxhimi i pasurisë</b>	
	Tek menaxhimi i pasurisë (4, faqe 11), tek furnizimi me llap-top ne nuk posedojmë me evidence te pagesës, furnizimit dhe regjistrimit për pasuri meqë ky llap-top nuk ka kaluar përmes shërbimeve tona përkatëse andaj nuk ka mundur te jete fizikisht prezent dhe i regjistruar ne pasurinë e ZPK-se.	<b>Mbesin konstatimet ne Raport.</b>  <b>Nuk na është ofruar dëshmi se Llap-topi i pranuar nga zyrtaret e ZPK i është kthyer furnizuesit.</b>
<b>2.</b>	<b>Shpenzimet e udhëtimit</b>	
	CPO-Nr. 1020175 ne shume prej 5652,45 euro qe prezantohet si gabim, ka te beje me udhëtimet e Kabinetit te Presidentit ne SHBA ne Nëntor te vitit 2006. Këtu është bere një gabim teknik intern i shërbimit financiar me rastin e arsytirmit financiar te MEF. Fjala është për konvertim përmes te internet it te faturave te lëshuara nga hoteli "Milenium" ne Nju Jork ku pas shumes përfundimtare figuron një shkurtese DM nga e cila ka rezultuar gabimi ynë ne trajtimin e kësaj shume si te ishte fjala për DM (Deutsche Markë). Por fjala është për initiale te personit qe ka likuiduar pagesën - këtë e kemi sqaruar ne kontaktet tona me hotelin ne fjale. Mbyllja e avansit për këtë rast është bere ne valutën Euro përmes CPO- Nr. 1020175.	<b>Bazuar ne Shkresën e datës 31 Maj 2007 lidhur me sqarimin e mbylljes se avansit, ne mund te ndryshojmë raportin tone tek tabela paqartësitë dhe gabimet, megjithëse ky ndryshim nuk ndikon ne ndryshimin e opinionit ton sa i përket Pasqyrave Financiare te ZPK.</b>
<b>3.</b>	<b>Shërbimet e kontraktuara</b>	
	CPO-Nr. 06215 me shume 175.000 euro, qe ka te beje me lenden Decotec, kontrate për pajisje te sigurisë qe është shkëputur ne bashkëpunim dhe pajtim me Zyrën Ligjore te UNMIK-ut, kurse pagesa është bere mbi baze te Vendimit te Qeverise se Kosovës Nr. 04/229 te datës 20.12.2006, për te evituar pasojat nga padija gjyqësore ne Gjykatën e Arbitrazhit, kështu qe për ZPK-ne është e qarte se është një pagese kompensimi për dëmshpërblim ndaj Decotec për shkëputje me marrëveshje te kontratës.	<b>Mbesin konstatimet ne Raport.</b>  <b>Komenti i ZPK-se nuk ofron dëshmi te duhura rreth te gjeturave ne raport ne te cilin janë paraqitur qarte ne disa pika, dhe pagesa si kompensim i dëmit ka dëmtuar buxhetin e Kosovës.</b>
	CPO-Nr. 030143 thuhet se nga shuma e përgjithshme prej 7344,80 euro, pagesa prej 5100,71 euro është bere pa mbulese. Kjo nuk qëndron. Fjala është për tre persona, te cilët ne këtë kohet kryenin shërbime konsulente me kontrate. Për një person kontrata është lidhur me 14.02.2006 me shume mujore prej 748,03 euro kurse pagesa është bere me 18.07.2006, pra 5.5 muaj me vonese. Shuma bruto prej 4.114,20 euro është rezultat i shume se kontraktuar prej 748,03 ne muaj here 5.5 muaj. Ne këtë shume janë paguar kontributet, ndërsa pala kontraktuese ka marre pagesën neto, kurse shuma tjetër prej 3230,60 euro ka te beje me diferencën për dy persona te tjerë te cilët kane kaluar nga	<b>Për një person i cili e ka pasur kontratën 14.02.2006 mund të pranojmë se shpenzimet janë bërë në mënyrë të arsyeshme, por e gjetura jonë për dy personat tjerë, kontratat e të cilëve janë lidhur me 30.06.2006 mbetet e pandryshuar, për arsye se në nenin 2 të kontratës thuhet se pagesa do të bëhet prej datës 01.07.2006, pagesa retroaktive për 6 muaj të vitit 2006 nuk ceket në</b>

	marrëdhënia e rregullt e punës në punë me kontratë për shërbime konsulente. Njërit nga ata i është paguar shuma prej 1653,60 euro bruto në mënyrë retroaktive për 6 muaj të vitit 2006. Kurse tjetrit 1227,25 euro bruto po ashtu për 6 muaj të vitit 2006.	<b>kontratë.</b> <b>Ndryshimi është paraqitur në tabelën nr. 6.</b>
<b>4.</b>	<b>Blerje tjera</b>	
	CPO-Nr. 1020129 në shumë prej 139.863,85 euro ka të bëjë me shërbimet e mirëmbajtjes softuerike dhe licencat nga kompania Inet-Shkup për vitin 2005 dhe tremujorin e parë të vitit 2006. Me këtë kompani ZPK-ja ka pasur kontratë tre-vjeçare dhe aktualisht i kemi ende borxh për shërbime të ofruara gjatë vitit 2006 por kontrata është shkëputur më 22.11.2006. ZPK e shfrytëzon ende këtë sistem softueri edhe pse pa licencë afati i të cilave ka skaduar.	<b>Bazuar në Shkresën e datës 31 Maj 2007 lidhur me sqarimin e shërbimeve që i ka kryer kompania “Inet” Shkup, në mund të ndryshojmë raportin tonë tek tabela paqartësitë dhe gabimet, megjithëse ky ndryshim nuk ndikon në ndryshimin e opinionit tonë sa i përket Pasqyrave Financiare të ZPK.</b>

